



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

---

KF.nr.880/22

GJYKATA KOMERCIALE, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal, me gjyqtarin Fisnik Nuli, dhe me bashkëpunëtorin profesional Visar Gashi në kontestin tregtar administrativ të paditësit N.T.P. “G...” me seli në Vushtrri, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Avokat A.D, kundër të paditurit Administrata Tatimore e Kosovës me seli në Prishtinë, duke vendosur lidhur me padinë e paditësit për anulimin e vendimit, objekt kontesti vlerësim tatimor, vlerë kontesti e papërcaktuar, në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor publik, të mbajtur me datë 25.10.2022, në prani të përfaqësuesit të paditësit, Avokat A.D, dhe në mungesë të përfaqësuesit të autorizuar të paditurit, mori, këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET kërkesëpadia e paditësit N.T.P. “G...” me seli në Vushtrri, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Avokat A.D, si e bazuar.
- II. ANULOHET Pjesërisht vendimi nr. 357/2019 i datës 30.09.2019, i Departamentit të Ankesave i Administratës Tatimore të Kosovës në Prishtinë dhe atë vetëm në pikën lidhur me stoqet për periudhën tatimore 2008 si dhe ngritjen e çmimeve për këtë periudhë, dhe lënda në këtë pjesë kthehet në RISHQYRTIM DHE RIVENDOSJE tek e paditura.
- III. Vlerësimet tjera tatimore sipas raportit të kontrollit nr. 10501 të datës 22.06.2022 të Administratës Tatimore të Kosovës, e të vërtetuara me vendimin kontestues 357/2019 i datës 30.09.2019, mbesin të pa ndryshuara.
- IV. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi me padinë e paraqitur në Gjykatë, me datë 04.11.2019, ka iniciuar kontestin tregtar administrativ kundër të paditurit Administratës Tatimore të Kosovës me seli në Prishtinë, ndaj vendimit A.nr. 357/2019 i datës 30.09.2019, për shkak se ATK-DA nuk ka përfillur rekomandimet e gjykatës sipas vendimit nr.497/14 të datës 03.07.2019 dhe

ka mbetur i njëjtë me vendimin e mëparshëm të DA. Sjellja jo profesionale e inspektorit dhe kalkulime të pa mbështetura në prova nuk mund të justifikohen duke i parë gabimet e shumta që nga fillimi e deri në përfundim të kontrollës gjë që ne nuk jemi trajtuar sipas nenit 27 të UA 15/2010 paragrafët 7.7.2, 7.7.4, 7.8.4 e 10.5. Në të gjitha ankesat e mëparshme kemi argumentuar vërtetimin e stoqeve të datës 31.12.2008 në bazë të shënimeve të Librit të Blerjes dhe Shitjes andaj vlera e cekur në vendim nuk është aspak e vërtetë. Në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor dhe në fjalën përfundimtare, përfaqësuesi i paditësit deklaroi se mbetet në tërësi pranë deklaramëve të gjertanishme, deklaroi se ekspertizën financiare të punuar nga grupi i ekspertëve e ka pranuar dhe lidhur me të njëjtën nuk ka vërejtje sa i përket gjobave, sa i përket faturave të pa pranuar nga ATK-Kontrolli si dhe faturave për qëllime të njohjes së shpenzimeve. Pra në këto pika i pranoni në tërësi konstatimet e grupit të ekspertëve e të cilat janë në harmoni edhe me të gjeturat e ATK-së, dhe njoftoni gjykatën se tanimë këto tri pika nuk janë objekt kontesti, mirëpo sa i përket konstatimit dhe mendimit të ekspertit si në ekspertizë referuar gjendjes së stoqeve me datë 31.12.2008 dhe ngritjes së çmimeve konsideron se këto dy pika grupi i ekspertëve ka dhënë mendim dhe konstatim që i vërtetojnë pretendimet e paditësit, pra ndryshe nga ajo që është vërtetuar nga ATK-ja. Në këtë seancë bën precizimin e padisë ashtu që kërkon nga gjykata që të aprovohet padia dhe kërkesëpadia e paditësit si e bazuar, të anulohet vendimi i të paditurës nr.357/2019 i datës 30.09.2019 dhe obligohet e paditura edhe një herë në rivendosje që konform ekspertizës financiare të datës 11.08.2022 të rregulloj-korrigjoj konstatimet lidhur me stoqet për periudhën tatimore 2008 si dhe të argumentoj se si ka ardhur deri tek rritja e çmimeve e aplikuar për periudhën kontestuese, dhe të argumentoj se si këto dy të gjetura kanë ndikuar financiarisht në qarkullimin shtesë për paditësin.

E paditura, në përgjigjen në padi të datës 03.03.2021, ka kundërshtuar pretendimet e paditësit të paraqitura në padi si të pa bazuara në ligj dhe fakte materiale, për arsye se konsideron se nuk është e bazuar në prova materiale dhe fakte të bazuara pasi që ATK pas rishqyrtimit të rekomandimeve të Aktgjykimit Anr.497/14 të GJTHP të datës 03.07.2019 të cilat rekomandime i ka përfillur në tërësi bazuar nga aktgjykimin në fjalë për veprimet që duhet të merren gjatë rivendosjes si dhe pas administrimit dhe vlerësimit të gjitha provave në shkresa të lëndës duke u bazuar në legjislacionin tatimor në fuqi përkatësisht nenit 14, 15 dhe 19 të Ligjit Nr.03/L-222 mbi Administratën Tatimore dhe Procedurat ka nxjerrë vendimin nr.357/2019 të datës 30.09.2019. Sa i përket pretendimit

të paditësit se konstatimi i drejtë dhe i saktë i gjendjes së stoqeve të datës 31.12.2008 për periudhën e kontrollit bazuar në librat dhe regjistrimet e tatimpaguesit nuk është vërtetuar në bazë të provave dhe vlerave me të cilat do ishte vërtetuar saktësia, ATK konstaton se ky pretendim nuk qëndron pasi që ATK bazuar në rekomandimet e Aktgjykimit Anr.497/17 të GJTHP ka siguruar informata nga regjioni që vërtetojnë se kontrolli ka filluar nga gjendja e stokut me 31.12.2007 dhe atë duke u bazuar në blerjet e prezantuara nga tatimpaguesi si dhe sipas shënimeve. ATK konstaton se gjendja e stoqeve është vërtetuar në mënyrë të saktë duke u mbështetur në analizën materiale të stoqeve të prezantuara nga vetë tatimpaguesi dhe si rezultat ATK vendos si në dispozitiv në mbështetje të provave të prezantuara nga të dyja palët dhe duke konsideruar prova më të besuara me të cilat do vërtetohej gjendja e saktë e stoqeve datës 31.12.2008, dhe i propozon Gjykatës që ta refuzoj në tërësi si të pabazuar padinë/kërkesëpadinë e këtui paditësit, dhe ta vërtetoj si të drejtë dhe të bazuar në ligj vendimin e departamentit të ankesave të ATK-së nr. 357/2019 datë 15.09.2019. Në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor dhe në fjalën përfundimtare, përfaqësuesi i të paditurit edhe pse i ftuar në mënyrë të rregullt nuk ka prezantuar, ndërsa me parashtrësën – njoftimin e datës 20.10.2022 e njofton Gjykatën se nuk do të prezantoj në seancë duke kërkuar nga Gjykata të veproj në pajtim me nenin 38, par. 5 të LKA-së, ndaj gjykata ka proceduar tutje komfor nenit 41, të LKA-së.

Gjykata ka shqyrtuar këtë konflikt administrativ konform dispozitave të nenit 41 të LKA-së për arsye se e paditura përmes parashtrësës së datës 20.10.2022 e ka njoftuar gjykatën se nuk do të prezantoj në këtë seancë dhe ka kërkuar që të veprohet konform nenit 38 të LKA-së. (Provë: parashtrësja e datës 20.10.2022 nga ATK-ja).

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, Gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit gjyqësor kryesor publik të datës 25.10.2022 ka administruar provat dhe atë: Vendimi nr.357/2019 i datës 30.09.2019, nr.45/2014 i datës 21.03.2014, Përgjigja në padi e datës 03.03.2021, Faturat nr.113/08, C/2-e, C/1-e, Rivlerësimet për TAP për periudhën 2008 dhe 2009, Rivlerësimet për TVSH për periudhën 2008 dhe 2009, Dokumentet e Vendosijes së Ndëshkimeve MFA2R0000077223C dhe MFA2R0000077222A, Përkujtesat për pagesat e vonuara gjithsejtë 20(njëzet) sosh, Rivlerësimet për Kontributet Pensionale për periudhat 03, 06, 09, 12/2009, Ekspertiza Financiare e pranuar nga eksperti financiar R.S datë 19.04.2022, Ekspertiza e punuar nga

Grupi i Ekspertëve Financiar datë 11.08.2022, Tabela blerjet dhe shitjet 2008 dhe 2009 si dhe faqja e fundit e Librit të blerjeve lidhur me stoqet e bartura nga viti 2007 dhe vlerën e tyre, Deklaratat e të hyrave dhe shpenzimeve sipas aktiviteteve për periudhën 2009, Tabela naftë-benzinë blerje dhe shitjet mujore 2009 e datës 31.12.2009, Parashtresa e datës 20.10.2022 e ATK-së lidhur me ekspertizën financiare.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues, thëniet në padi, përgjigje në padi, shkresave të lëndës në këtë konflikt administrativ, bëri ballafaqimin e provave që kanë ofruar të dy palët, dhe bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, mbështetur edhe në dispozitat nga neni 8, i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), dhe arriti në përfundimin se në këtë konflikt administrativ, duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye:

Nga provat e administruara në këtë kontest tregtar administrativ, deklarimeve në padi dhe përgjigje padi, shkresat e lëndës, vendimi kontestues, ekspertiza financiare dhe deklarimeve në seancën e shqyrtimit gjyqësor, Gjykata ka gjetur se nuk është kontestuese fakti se paditësi ka pranuar raportin e kontrollit të datës 27.08.2013, nga e paditura, me ç'rast nga gjetjet e të njëjtit është konstatuar qarkullim dhe tatim shtesë për TVSH për vitet 2008 - 2009, TAP – zvogëlim të humbjes, Kontribut pensional shtesë për pronarin, Ndëshkime si dhe zvogëlim kreditim të TVSH. Jo kontestuese mbesin edhe faktet se paditësi, ka ushtruar ankesë pranë departamentit të ankesave në ATK-ë, e për të cilën ankesë, ATK-ja me datë 31.03.2014, ka sjell vendimin nr. 45/2014, si akt administrativ përfundimtar i nxjerrë në procedurën administrative në shkallë të dytë. Tutje lidhur me këtë lëndë kjo Gjykatë duke vendosur sipas padisë së paditësit me Aktgjykimin A.nr.497/14 të datës 03.07.2019, ka aprovuar padinë e paditësit dhe lëndën e ka kthyer në rishqyrtim dhe rivendosje, ndërsa e paditura duke vepruar sipas këtij Aktgjykimi në Rishqyrtim – rivendosje ka sjell aktvendimin nr.375/2019 të datës 30.09.2019, me të cilin prapë ka refuzuar ankesën e këtij paditësi e ndaj të cilin aktvendim paditësi me padinë e datës 04.11.2019 ka iniciuar prapë këtë konflikt administrativ.

Gjykata konstaton se vendimi i kontestuar sa i përket konstatimit të gjendjes së stoqeve për periudhën 2008 dhe ngritjes së çmimit të shitjeve me shumicë, nuk përmban arsye mbi faktet vendimtare, të vlefshme për zgjidhjen e drejtë të çështjes në shqyrtim. Në fakt, në vendimin e kontestuar por edhe në raportin e kontrollit i cili herën, nuk është vërtetuar

drejt gjendja faktike sikurse edhe nga faktet e vërtetuar është nxjerr konkluzion jo i drejtë në pikëpamje të gjendjes faktike.

Gjykata vëren se e paditura në vendimin kontestues nuk i ka trajtuar pretendimet ankimore të paditësit sa i përket gjendjes së stoqeve dhe ngritjes së çmimeve të shitjes me shumicë, por i ka mjaftuar arsyetimi se kontrolli ka filluar nga gjendja e stokut me 31.12.2007 bazuar nga blerjet e prezantuara nga paditësi, ndërsa sa i përket ngritjes së çmimit të shitjeve me shumicë, e paditura ka konstatuar se rritjen e çmimeve me shumicë e ka bërë vetëm të shitjet në subjektet fiktive, që tatimpaguesi nuk ka aplikuar fare fitim, përkundër dëshmimeve të prezantuara nga tatimpaguesi, Departamenti i Ankesave vlerëson kontrolli ka vepruar bazuar dokumentacionin në dispozicion. Një arsyetim i këtillë i cili nuk e ka shpjeguar bazën ligjore dhe faktike të vlerësimit të gjendjes së stoqeve dhe ngritjes së çmimit të shitjes me shumicë, nga ana e të paditurës është i pa pranueshëm për gjykatën, dhe si i tillë është i barsvlershëm me mungesën e arsyetimit.

Gjykata në këtë kontest tregtar administrativ e duke vepruar sipas propozimit të përfaqësuesit të autorizuar të palës paditëse ka aprovuar nxjerrjen e provës përmes ekspertizës financiare, fillimisht nga eksperti Remzi Smajli e datës 19.04.2022, dhe pastaj edhe nga grupi i ekspertëve financiar B.M, I.K, Xh.K e datës 11.08.2022. Nga vlerësimet dhe konstatimet e nxjerra të ekspertëve financiar në ekspertizën financiare të datës 11.08.2022 dhe të paraqitura edhe në shqyrtimin kryesor publik të datës 25.10.2022, është dhënë mendimi profesional sipas të cilit gjobat që janë aplikuar ndaj paditësit janë dy: a) në vlerë nga 125.00€ për periudhën 12/2008 datë 10.01.2014, dhe b) gjoba në vlerë prej 125.00€ për periudhën 12/2009 datë 10.01.2014. këto vlera janë inkasuar nga llogaria bankare e tatimpaguesit. Bazuar në librat afariste të kontabilitetit material të subjekti ekonomik NTP G... me seli në Vushtrri, gjendja e stoqeve me datë 31.12.2008 është benzinë 82,453.07l dhe naftë 39,067.87l. Nuk ka dëshmi në dokumentacionin në dispozicion për ekspertizën financiare se kur ka ndodh në çfarë kohe dhe për cilët artikuj shitës ka pas ngritje të çmimeve. Faturat e pranuar nga ATK-kontrolli, janë evidentuar në faqen 11 të ekspertizës financiare dhe grupi ekspertëve konstaton se ato fatura nuk i plotësojnë kushtet ligjore për njohje si blerje edhe pse janë paguar nga blerësi – shitësit, por që nuk i kanë elementet e mjaftueshme si numri i TVSH, numri i biznesit, numri fiskal etj. Tatimpaguesi kontrollit i ka ofruar faturat për qëllime të njohjes së shpenzimeve. Shpenzimet operative të tatimpaguesit janë të përfshira në

ATK- Raport Kontrolli për vitin 2008 dhe 2009 si shpenzime operative të biznesit. Në seancën e shqyrtimit kryesor eksperti financiar deklaroi B.M deklaroi se Ekspertiza financiare datës 11.08.2022 lidhur me këtë lëndë për subjektin ekonomik NTP “G...” me seli në Vushtrri, është hartuar në bazë të dokumentacionit në dispozicion, si dhe verifikimit në pamje të Librave Afariste që tatimpaguesi këtu paditësi i ka mbajtur Kartelat Kontabël në aspektin financiar, por ka pasur edhe evidenca të kontabilitetit material. Në faqen 9 të ekspertizës janë shënuar edhe numri rendor për sasinë e blerjeve të Libri i Blerjes si dhe numri rendor të Libri i Shitjes për sasinë e shitur, dhe në bazë të këtyre të dhënave grupi i ekspertëve ka konstatuar se gjendja e stoqeve me datën 31.12.2008 për artikullin “Benzinë” është 82,453.07 litra, dhe për artikullin “Naftë” është sasia 39,067.87 litra. Kjo ka qenë edhe një prej detyrave në aktvendimin e gjykatës për vëllimin e objektit të ekspertizës për grupin e ekspertëve. Tatimpaguesi ka paguar dy gjoba me nga 125.00 € secila veç e veç, dhe tek mendimi dhe konstatimi sikurse në faqen 14 të ekspertizës është cekur edhe numri i dokumentit të Unirefit si dhe data e pagesës së këtyre dy gjobave. Grupi i ekspertëve nuk ka pasur dëshmi faktike të prezantuara nga këtu paditësi gjatë ekzaminimit të materialit se kur ka ndodhë dhe për cilin artikull ka pasur ngritje të çmimeve. Gjithashtu, është konstatuar se subjekti afarist NTP “Graniti Petrol” ka afaru me humbje për vitin fiskal 2008 në vlerë financiare prej 39,486.87 €, dhe në vitin fiskal 2009 për vlerën financiare prej 23,633.90 €. Gjambat e shqiptuara, respektivisht dy të tilla me nga 125.00 € secila, janë rezultat i konstatimit nga ana e Inspektorit të ATK-së, për arsye të dokumentacionit siç është rasti i faturave të pa pranuar apo edhe të raportimeve të pa sakta. E njoftoj gjykatën se pagesa lidhur me këtë ekspertizë ashtu siç është përcaktuar nga gjykata, e njëjta është realizuar, pra konsiderohet e paguar.

Në procedurën e kontestit tregtar administrativ gjyqësor, Gjykata duke qenë se bazuar në dispozitën nga neni 44, par 1, i LKA-së, ku është përcaktuar qartë se “Ligjshmëria e aktit administrativ të kontestuar shqyrtohet nga gjykata brenda kufijve të kërkesës nga Padia”, dhe pasi që përfaqësuesi I autorizuar I këtu paditësit në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor pas precizimit të kërkesë padisë shprehimisht në pikën III, propozon që *“Obligohet e paditura edhe një herë në rivendosje që konform ekspertizës financiare të datës 11.08.2022 të rregulloj-korrigjoj konstatimet lidhur me stoqet për periudhën tatimore 2008, si dhe të argumentoj se si ka ardhur deri tek rritja e çmimeve e aplikuar për periudhën kontestuese, dhe të argumentoj se si këto dy të gjetura kanë ndikuar*

*financiarisht në qarkullimin shitesë për këtu paditësin“*, dhe pasi ka shqyrtuar gjithë dokumentacionin e lëndës konstaton se nga konkluzionet e nxjerra në procedurën administrative dhe provave të theksuara në arsyetimet e vendimit të të paditurës, sa i përket konstatimit të gjendjes së stoqeve dhe rritjes së çmimit të shitjes për shitjet me shumicë nuk mund të vërtetohet plotësisht gjendja faktike dhe se ekzistojnë kontradikta në mes konstatimeve të cekura pa i arsyetuar mjaftueshëm me prova konkrete, kjo e vërtetuar edhe me ekspertizën financiare të datës 11.08.2022.

Gjykata e mori në tërësi si të bazuar dhe ia dha besimin e plotë ekspertizës së punuar nga grupi i ekspertëve të datës 11.08.2022, ngase e njëjta i përmban elementet e nevojshme të dhëna mbi bazën e njohurive profesionale, dhe arsye të mjaftueshme të cilat gjykata i vlerësoj si të drejta për vërtetimin e fakteve vendimtare në këtë kontest tregtar administrativ, sa i përket konstatimit të gjendjes së stoqeve dhe rritjes së çmimit të shitjes për shitjet me shumicë si dhe e njëjta është në harmoni me legjislacionin tatimor të aplikueshëm.

Gjykata konstaton se në vendimin e kontestuar të Departamentit të Ankesave të ATK-së me nr.59/2009 i datës 02.04.2009, është konstatuar se vlera e stoqeve për vitin 2008 është nxjerr bazuar në librat dhe regjistrimet e tatimpaguesit duke filluar nga gjendja e stokut me 31.07.2007, bazuar në blerjet e prezantuara nga tatimpaguesi dhe po ashtu ka zbritur edhe shitjet e naftës dhe të benzinës dhe ka rezultuar stoku 32,392.00€, mirëpo nga dokumentet e prezantuara nga pala paditëse dhe konstatimet e nxjerra në ekspertizën financiare gjykata nxjerr konstatimin se vlera fillestare e stoqeve për vitin 2008 ka qenë 61,261.98L naftë dhe 39,695.00L benzinë. Gjendja e stoqeve sipas regjistrimit me datë 04.08.2008 ka qenë 47960.00L naftë dhe 39675.00L benzinë, e cila krahasuar me blerjet dhe shitjet e realizuara gjatë kësaj periudhe të cilat i shtohen/zbriten saldosh fillestare të stoqeve, rezulton me diferencë -333.551 për naftë dhe -145.23litër për benzinë. Përderisa nuk ka dëshmi se në cilën orë ose kohë është ndërprerë puna në pompa që të merret për bazë matja a stoqeve, nuk mund të konstatohet edhe rrjedha e kësaj difference. Duke u nisur nga gjendja e stoqeve të konstatuara nga ekspertiza financiare për datën 05.08.2008 47,626.451 naftë dhe 39,698.001 benzinë, shtuar/zbritur këtyre blerjet dhe shitjet për periudhën 05.08-31.12.2008, në fund të vitit 2008 ka rezultuar vlera e stoqeve 39,067.871 naftë dhe 82,453.071 benzinë. Të gjitha këto konstatime janë nxjerr nga librat dhe regjistrimet e paditësit. Andaj nga kjo gjendje faktike e konstatuar nga ekspertiza

financiare gjykatat nuk e pranon si të bazuar pretendimin e të paditurës se kontrolli është bazuar në librat dhe regjistrimet e tatimpaguesit kur ka vërtetuar gjendjen e stokut.

Gjykata po ashtu konstaton se e paditura në vendimin kontestues nuk ka qenë në gjendje në asnjë moment të arsyetoj se mbi cilën bazë ligjore ka aplikuar rritjen e çmimeve për shitjet me shumicë dhe cilat janë konkretisht ato shitje për të cilat është aplikuar rritja e çmimit të shitjes, por vetëm është mjaftuar me konstatimin se kontrolli rritjen e çmimeve me shumicë e ka bërë vetëm te shitjet në subjektet fiktive, por pa vërtetuar edhe se kush janë këto subjekte fiktive dhe si janë konstatuar si të tilla.

Gjykata rithekson se ne nenin 19.2 të ligjit 04/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat parashihet *“Vlerësimi i Drejtorit të Përgjithshëm do të bëhet sipas gjykimit të tij ose saj më të mirë dhe do të bazohet në të gjitha provat që ai ose ajo ka në dispozicion, përfshirë: 2.1. librat, regjistrimet, kuponët, faturat, ose informatat tjera përkatëse të tatimpaguesit; 2.2. librat, regjistrimet, kuponët, faturat, ose informatat tjera përkatëse të personave të tretë; 2.3. informatat nga personat të cilët mund të verifikojnë saktësinë e deklaratave, librave dhe regjistrimeve të tatimpaguesit, 2.4. informata të tjera objektive rreth të ardhurave ose shitblerjeve të tatimpaguesit lidhur me detyrimin e tij. 2.5. informatat e siguruara gjatë vizitave tek tatimpaguesit sikurse është paraparë në paragrafin 1 të nenit 14 të këtij ligji; 17 2.6. aplikimin e këtij Ligji dhe/apo ligjet e aplikueshme të tatimeve në të ardhura apo TVSh në Kosovë”*. Ndërsa në nenin 81F paragrafi 2 të Ligjit 04/L-102 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Për Administratën tatimore dhe Procedurat nr.03/L-222 shprehimisht parashihet se *“Administrata tatimore, doganore apo ndonjë administratë tjetër do të bart detyrimin e vërtetimit të fakteve të cilat e mbështesin vendimin dhe kundërshtojnë kërkesën e tatimpaguesit”*

Gjykata vendos për çështjen e kontestit tregtar administrativ në bazë të fakteve të vërtetuara në procedurë administrative, në vështrim të nenit 43 paragrafi 1 të LKA-së. Duke pasur parasysh konstatimet e lartcekura, gjykata konkludon se në këtë kontest tregtar administrativ ekzistojnë të meta të cilat pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë për arsye se në vendimin kontestues nuk janë dhënë arsye të bazuara lidhur me konstatimin e gjendje së stoqeve për vitin 2008 dhe rritjes së çmimeve për shitjet me shumice.



Prandaj me qëllim të konstatimit të drejtë të çështjes, me prova materiale shtesë, lidhur me qarkullimin dhe tatimin shtesë për periudhën e kontrollit, si pasojë e ndryshimit të gjendjes së stokeve dhe rritje së çmimit të shitjeve me shumicë, e paditura duhet të verifikoj dhe siguroj prova shtesë, në mënyrë që konstatimi i dhënë në vendimin kontestues të mbështetet në prova materiale. Gjykata kërkon nga e paditura të konstatoj drejtë dhe saktë gjendjen e stokeve për paditësin për periudhën e kontrollit, bazuar në librat dhe regjistrimet e paditësit, duke u mbështetur në librin e shitjes dhe të blerjes. Gjithashtu e paditura në rivendosje duhet të deklarohet lidhur me rritjen e çmimit të shitjeve me shumicë, ashtu që të arsyetohet bazën ligjore mbi të cilën është mbështetur kur ka bërë ngritjen e çmimeve. E paditura në rivendosje lidhur me këto dy çështje të marr për bazë të gjeturat nga ekspertiza financiare e datës 11.08.2022, e punuar nga grupi i ekspertëve financiar B.M, I.K dhe Xh.K, dhe vetëm pas kësaj dhe mbi bazën e kësaj ekspertize të marr vendim meritor në këtë çështje.

Të metat e cekura më lartë pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit të kontestuar dhe në këtë drejtim gjykata e obligon të paditurën që në ri procedurë të veproj sipas vërejtjeve të dhëna në këtë aktgjykim, dhe pasi t'i mënjanoj këto të meta të merr vendim të drejtë dhe të bazuar në ligj.

Vlerësimet tjera tatimore sipas raportit të kontrollit nr. 10501 të datës 22.06.2022 të Administratës Tatimore të Kosovës, e të vërtetuara me vendimin kontestues 357/2019 i datës 30.09.2019, mbasin të pa ndryshuara, ngase këto të gjetura nuk janë kundërshtuar nga këtu paditësi fakt këtë të cilin e vërteton edhe përfaqësuesi i autorizuar i këtu paditësit në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 25.10.2022, ku shprehimisht thekson se *“neve si palë paditëse nuk kemi vërejtje sa i përket gjobave, sa i përket faturave të pa pranuar nga ATK- Kontrolli, si dhe faturave për qëllime të njohjes së shpenzimeve. Pra, në këto pika i pranojmë në tërësi konstatimet e grupit të ekspertëve, e të cilat janë në harmoni edhe me të gjeturat e ATK-së. Pra njoftojmë gjykatën se tanimë këto tri pika nuk janë objekt kontesti në këtë lëndë “*, andaj edhe gjykata nuk është lëshuar më tej në vlerësim dhe elaborim të të njëjtave.

Gjykata vendos për çështjen e kontestit tregtar administrativ në bazë të fakteve të vërtetuara në procedurë administrative, dhe në vështrim të neneve 43, paragrafi 1, dhe 44, paragrafi 1, të LKA-se. Në bazë të këtij parimi, Gjykata Ligjshmërinë e aktit administrativ të kontestuar e shqyrton brenda kufijve të kërkesës nga padia, andaj edhe e ka të pamundur të vendos në mënyrë meritore në këtë kontest tregtar administrativ ngase vet përfaqësuesi i paditësit kërkon që lënda të kthehet edhe njëherë në rivendosje tek e paditura por edhe për faktin se ekzistojnë të meta të cilat e pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit të kontestuar, andaj e aprovon padinë e paditësit, anulon vendimin e kontestuar në pikën që i referohet konstatimeve lidhur me stoqet për periudhën tatimore 2008 si dhe rritjes së çmimeve të aplikuar për periudhën kontestuese, dhe lënda kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje në këtë pjesë. Gjykata bazuar në autorizimet nga neni 43 par.2 të LKA-së e detyron të paditurën, që në ri procedure të veprojnë sipas vërejtjeve të dhëna në arsyetim të këtij aktgjykimi.

Vërejtjet e cekura janë të obligueshme për organin e paditur, edhe duke u bazuar në nenin 65, të Ligjit për Konfliktet Administrative.

Vendimin që secila palë ti bartë shpenzimet e procedurës, Gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 64 të LKA-së nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative.

Nga sa u tha më lartë, gjykata në pajtim me dispozitat ligjore të nenit 43 par.2, dhe 46 par 1, 2 dhe 3, të LKA-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## GJYKATA KOMERCIALE

Departamenti Fiskal, Dhomat e Shkallës së Parë

KF.nr.880/22, datë 25.10.2022

Bashkëpunëtor Profesional

Visar Gashi

G j y q t a r i

Fisnik NULI

---

### KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi, është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, dhomave të shkallës së dytë, përmes dhomave të shkallës së parë të kësaj Gjykate.